

Emri i Lëndës : Editim Audio dhe Video							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
MUL 204	B	Pranverë	2.00	0.00	0.00	1.50	3.00
Lektori		Nevila Samarxhi, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program Profesional 2-Vjeçar					
Përshkrimi		Në këtë lëndë flitet mbi konceptet teknike të punës në ekip apo të individualizuar për realizimin e produkteve audio dhe video, editimin i audios dhe i videos për mediat tradicionale audio vizuale, apo i përshtatur për mediat sociale, ka rëndësi jetike për mesazhet që ata përçojnë tek publiku. Nëpërmjet kësaj disipline, studentët do të aftësohen me njohuri mbi rolin dhe teknikat e editimit me qëllim përfitimin e materialeve të vlefshme për transmetim. Kjo lëndë do të ofrojë njohuri të thella për teknikat dhe mjetet e editimit të materialeve audio-video, duke përfshirë software, teknika të avancuara dhe kreativitetin në krijimin e përmbajtjeve. Studentët do të mësojnë se si të punojnë me projekte të ndryshme, duke u fokusuar në përdorimin e mjeteve të editimit dhe optimizimin e përvojës audio-video.					
Objektivat		Synimet e kësaj lëndë janë që në përfundim të saj, studentët të kenë njohuri mbi rolin, përdorimin dhe efektet e teknologjisë në proceset edituese për audion dhe videon. Të njohin përdorimin e saktë të tyre, në përshtatje me llojin e medias e të programacionit ku do të përdoren. Përvetësimi i software-ve për editim. Mësimi i teknikave të editimit audio dhe video (prerje, bashkim, përpunim). Kuptimi i proceseve të post-produksionit (miksing, tingujsh, pastrim audio, përmirësim vizual). Krijimi i projekteve profesionale audio dhe video për qëllime të ndryshme. Zhvillimi i aftësive krijuese dhe artistike në montazh dhe përdorim të efekteve.					
Konceptet Kryesore		1. Editim audio 2. Editim video 3. Kalime 4. Sekuenca 5. Audio efekte 6. Video efekte					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në Editimin Audio-Video/ Prezantimi lëndës! Në këtë leksion bëhet një hyrje e kursit. Hyrja përmban shpjegimin e objektivave të lëndës, përshkrimin e saj, si dhe shpjegimin e detajuar të temave të cilat do të zhvillohen javë pas jave. Po ashtu, gjatë këtij leksioni, studentët njihen me zërat e vlerësimit të lëndës, si dhe me projektet që do të kryhen gjatë semestrit për lëndën e Editimit të audios dhe të videos. Përdorimi i softuerëve kryesorë (Adobe Premiere Pro, Final Cut Pro, Audacity). Udhëzime për krijimin e projekteve të para. Diferencimi i formateve dhe rezolucioneve të videos.						
2	Njohja me programet e editimit. Importimi dhe vendosja e materialeve në timeline. Mjetet e punës Përgjatë këtij leksioni studentët njihen me programet e editimit të tilla si Adobe Audition; Adobe Premiere, etj. Bazat e Editimit Video. Importimi i materialeve. Shkurtime dhe ndarjen e videove. Përdorimi i timeline dhe kutisë së instrumenteve. Manipulimi i videos (rotacion, ngjitje, vendosje të efekteve bazë). Prezantimi i detyrës teorike: Tema: Analiza e Procesit të Post-Produksionit në Prodhimin e një Videoje dhe Audioje Profesionale						
3	Përdorimi i Efekteve të Thjeshta në Video: Krijimi dhe editimi i tekstit/ Mënyrat e vendosjes së grafikeve tekstuale, llojet e tekstit, specifikat që duhen pasur parasysh kur punojmë me tekstit. Po ashtu në këtë leksion do të trajtohen strishat dhe llojet e tyre, grafikat e gatshme si dhe grafikat e krijuara. Efektet vizuale të thjeshta. Transicioni mes videove. Krijimi i titujve dhe grafika të thjeshta. Implementimi i elementëve të brendshëm dhe të jashtëm të projektit. Prezantim dhe caktim i projektit për provimin gjysëm final.						

4	Regjistrimi dhe editimi i zërit në formën wave/ Përgjatë këtij leksioni do të punohen me editimin e të dhënave audio. Punimi do të bëhen në formë WAVE. Llojet e zërit mono dhe zërit stereo; konvertimi në secilin lloj, prerja dhe fshirja e pjesëve të zërit; ngjitja e pjesëve të zërit, aplikimi i efekteve të ndryshme; reduktimi i zhurmave, rritja dhe ulja volumit të zërit, etj. Editimin e zërit në Adobe Audition. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin gjysëm final.
5	Editimi Audio për Video / Leksioni bazohet kryesisht në editimin e zërit. Bazat e editimit audio. Përdorimi i audios në timeline. Rregullimi i niveleve të audios. Përdorimi i filtrave për përmirësimin e cilësisë së audios. Përdorimi i Muzikës dhe Efecteve të Tingujve. Si të përzgjidhni muzikë për projekte video. Implementimi dhe sinkronizimi i muzikës me imazhin. Përdorimi i efekteve të tingujve dhe ambientaleve. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin gjysëm final.
6	Editimi video me bazë audio: Sinkronizimi i zërit me videon; Në këtë leksion trajtohen karakteristikat e audios për video; roli dhe domosdoshmëria e ndërfaqeve për regjistrim, regjistrimi, importimi, volumi, ritmi, prerja, mbivendosja, efektet. Po ashtu trajtohen edhe sinkronia mes audios dhe videos, modelet e montimit, efektet paralele, dhe eksportimi i videos. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin gjysëm final.
7	Editimi audio dhe video: Aplikimi dhe rëndësia e imazheve kyçe (key frame) dhe efektet e kontrolluara; Karakteristikat e audios për video; Roli dhe domosdoshmëria e ndërfaqeve për regjistrim, regjistrimi, importimi, volumi, ritmi, mbivendosja e sekuencave. Praktikohen pikëzimet (key frame) si dhe roli që kanë në animin e imazheve dhe aplikimin e efekteve. Po ashtu trajtohen edhe sinkronia mes audios dhe videos, si dhe efektet paralele. Editimin e tekstit në Adobe Premiere Pro. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin gjysëm final.
8	Provimi gjysëm final/ Prezantim Video nga vetë studentët. Individuale ose grup
9	Editimi audio dhe video: prerja, ngjitja dhe streçimi i sekuencave; Editimi i videos duke ndërhyrë në to nëpërmjet prerjes, çfarë duhet të kemi parasysh kur presim sekuencat video, si i ndërtojme kuptimet dhe emocionet nëpërmjet prerjes; çfarë duhet të ndodh me audion kur presim sekuencat video. Po ashtu në leksion trajtohen ngjitja ose bashkimi i imazheve, si dhe streçimi i tyre. Leksioni bazohet kryesisht në editimin e tekstit në Adobe Premiere Pro. Prezantim dhe caktim i projektit për provimin final
10	Editimi i audio dhe video tranzicioneve; Analiza dhe praktika. Mënyrat e kalimit nga sekuenca në sekuenca qofshin këto sekuenca audio apo sekuenca video; aplikimin e efekteve vizuale dhe efekteve zanore. Dy llojet kryesore: efektet e paracaktuara dhe efektet mbi të cilat në kemi kontroll të plotë, pra efekte të krijuara nga edituesi. Editimin e tekstit në Adobe Premiere Pro. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin final.
11	Aplikimi i video dhe audio efekteve; Mënyrat e aplikimit të efekteve. Cilësimi ngjyrave dhe efekteve të tjera të aplikueshme në sekuencat video; prerja e kornizave, sfumimi i imazheve, stabilizimi i tyre, etj. Aplikimi i efekteve në sekuencat audio. Adobe Premiere Pro dhe Adobe Audition. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin final.
12	Zëvendësimi i sfondeve (green screen) dhe efektet mbi objekte; Mënyrat e zëvendësimit të imazheve dhe objekteve nëpërmjet metodës Croma Key. Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme aplikohet zëvendësimi të imazheve dhe objekteve në sekuencat video. Editimin e tekstit në Adobe Premiere Pro Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin final.
13	Editimi për platformat Aspektet teorike të montimit të tilla si planet, detajet, teknikat e editimit të filmit, kronikës dhe reklamës, llojet e ndryshme të prerjes, teknikat e regjistrimeve të efekteve zanore, lëvizjet e ngadalta dhe lëvizjet e shpejta të imazheve. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin final.
14	Eksportimi dhe formatet e ruajtjes së videos dhe audios; Finalizimi i punës së edituar duke bërë ruajtjen dhe eksportimin e saj. Po ashtu në këtë leksion do të trajtohen llojet dhe formatet e Ruajtjes së audios dhe të videos, për platforma të ndryshme në programet editimit (Adobe Audition; Adobe Premiere Pro; dhe Filmora), lidhjet dinamike mes sistemit multimedial Adobe Creative Cloud, si dhe eksportimi nëpërmjet Adobe Media Encoder. Vazhdim dhe diskutim i projektit për provimin final
15	Prezantim projektesh; Në këtë javë të parafundit studentët prezantojnë projektet semestrale në laborator, si dhe diskutohen rreth tyre në mënyrë kritike.
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura	• “The Technique of Film and Video Editing: History, Theory, and Practice”, Ken Dancyger, Sixth Edition, Routledge, London 2019 • “Film and Video Editing Theory: How Editing Creates Meaning”, Michael Frierson, Routledge, London 2018		
Referenca të tjera	• “Classroom in a book: The official training workbook from Adobe Systems”, Maxim Jago, Adobe Press 2019 • Samuel J. Sauls, Craig A. Stark (2018): Audio production, worktext. Concepts, techniques, equipment, Focal Press book, Ninth edition, Routledge, London		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studenti merr njohur mbi rolin e proceseve edituese.		
2	Studenti aftësohet mbi editimin e audios dhe rëndësinë e tij në transmetim.		
3	Në fund të ciklit të leksioneve studenti është aftësuar mbi editimin e videove.		
4	Një pikë e fortë është edhe aftësimi i editmit në platformat moderne digjitale		
5	Studenti mëson rreth situatave dhe kushteve të transmetimeve radiotelevizive dhe online.		
6	Studenti përfiton zotësi në njohjen gjuhës teknike dhe përdorimin e saj.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	30
Kuize		0	0
Projekte		1	10
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	1	3	3
Gjysmë finale	1	4	4
Provimi final	1	8	8
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			75
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			3.00
ECTS			3.00